



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 36, Datë 09.02.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC DUNICE”, ME NR. 123 , SERIA PV11K
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR.27, DATË
10.03.2011**

Në mbështetje të neneve 16; 42 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 5 gërmat “d” dhe “dh”; nenit 6 të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” miratuar me vendimin e Bordit nr. 54, datë 18.04.2017; pika 6, gërmat “d” dhe “dh” të kushteve për “Licencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurave për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC DUNICË”, me nr. 123, Seria PV11K miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 27, datë 10.03.2011.

Konstatohet se:

- Subjekti tregëtar “HEC –DUNICË” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 27, datë 10.03.2011, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me licencë nr. 123, Seria PV11K.
- Ky i licencuar ka paraqitur në ERE një kërkesë me nr. 08 Prot, datë 19.01.2018, protokolluar me tonën me nr. 104 Prot, datë 23.01.2018, për heqjen e licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et – “Trebinjë”, “Potgozhan2, “Kalivac”, “Dunicë 1”, “Dunicë 2” si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- MEI me shkresën me nr. 46/49 Prot, datë 26.04.2017, drejtuar shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k, për dijeni Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhje të kontratës së koncensionit me Nr. 2059 Rep, dhe Nr. 248/1 Kol, datë 16.06.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë, Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vortek” sh.p.k dhe “By Best Duty Free” sh.p.k dhe autoritetit Kontraktues ish Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HEC – DUNICË” sh.p.k, me nr. 123, Seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 27, datë 10.03.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC – et “Trebinjë”, “Potgozhan2, “Kalivac”, “Dunicë 1”, “Dunicë 2”.
2. Drejtoria e Licencimit dhe monitorimit të tregut, të njoftojë shoqërinë “HEC DUNICË” sh.p.k dhe MIE për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI